



KOMITETI OLIMPIK KOMBËTAR SHQIPTAR

INFORMACIONE

PRILL - MAJ 2006

Asambleja e përgjithëshme e ANOC - 201 Komitete Olimpikë mbledhen në Seul



Nga Asambleja e ANOC , Seul-Korea e Jugut

Më datë 2-5 Prill 2006 në Seul të Kores së Jugut, Shoqata e Komiteteve Olimpikë Kombëtare (ANOC) e kryesuar nga Presidenti i saj z. Mario Vazquez Raña, në prani të Presidentit të CIO z. Jacques Rogge, përfaqësuesve të Komiteteve Olimpikë dhe përfaqësuesve më të lartë shtetërorë të Koresë së Jugut, zhvilloi punimet e Asamblesë së Përgjithëshme të 15. Më tepër se 300 delegatë të 201 Komiteteve Olimpikë ndër 203 të tilla anëtare të ANOC diskutuan për çështje të rëndësishme për të ardhmen e ANOC, rritjen e rolit të Shoqatave Kontinentale në mbështetje të Komiteteve Olimpikë Kombëtare, luftës kundër dopingut, përmirësimi i Programit Olimpik, përdorimin më efektiv të burimeve të ofruara nga Solidariteti Olimpik dhe pjesmarrja në lojrat e ardhëshme Olimpikë. (marrë nga faqja zyrtare e internetit të CIO) Për KOKSH në këtë Asamble morrën pjesë Presidenti z. Domi dhe Sekretari i Përgjithshëm z. Bello.

KOK i Kosovës - Seminar për Administratorët e Sportit "Qeverisja e Organizatave Sportive"

Komiteti Olimpik i Kosovës ka organizuar në datën 10 Prill 2006 në ambjentet e Shtëpia e Sporteve seminar 1 ditor për administratorët e sportit me temë "Qeverisja e Organizatave Sportive". Me një pjesmarrje të gjerë të përfaqësuesve të federatave sportive Kosovare, drejtues klubesh dhe përfaqësues të Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit të Kosovës, seminari u ndoq me një interes të veçantë. Lektor në këtë seminar ishte Sekretari i Përgjithshëm i KOKSH z. Stavri Bello i cili njëkohësisht është edhe lektor i jashtëm për lëndën e "Organizimit të Sportit" pranë Akademisë së Edukimit Fizik dhe Sporteve "Vojo Kushi".

20 Prill 2006 – Akademia Olimpik e Kosovës vizitë pune në KOKSH

Në vijim të bashkëpunimit të frytshëm mes Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar dhe Komitetit Olimpik të Kosovës, një tjetër shkëmbim eksperience përsa i përket Akademive Olimpikë respektive, u zhvillua ndërmjet dy vendeve. Sekretari i Përgjithshëm i KOKSH Stavri Bello, Drejtori i Akademisë Olimpikë Shqiptare Arben Kaçurri dhe anëtari i Bordit të AOSH Përparim Ferunaj, kanë pritur në KOKSH në një takim zyrtar miqtë e Akademisë Olimpikë të Kosovës Prof. Dr. Arsim Fehmiu, Prof. Ylber Rudi dhe Inxh. Eshref Sahiti. Megjithëse takimi i parë i këtij lloji midis A.O. të Kosovës dhe A.O. Shqiptare, Drejtori i AOSHs Arben Kaçurri në mënyrë paronamike i'u ka prezantuar miqëve punën dhe eksperiencën e AOSHs. Të kënaqur nga ky takim, bashkëpunimi do të pasohet me një vizitë të AOSHs në Kosovë.



Nga takimi i AO të Kosovës në KOKSH

20 Prill 2006 – Mbledhje e Komisionit Mjekësor të KOKSH

Megjithëse pas një kohe të shkurtër mos funksionimi, Komisioni Mjekësor i KOKSH mbledhet sërish për tu riorganizuar. Kështu në datë 20 Prill 2006, në ambientet e KOKSH është zhvilluar mbledhja e parë e këtij Komisioni për mandatin 2005-2008. Komisioni me kryetar Dr. Muhamet Ostreni dhe anëtarët e tij, diskutuan në mbledhje sipas pikave të rendit të ditës:

- Riorganizimi i Komisionit Mjekësor
- Programi i Komisionit Mjekësor deri në vitin 2008
- Të ndryshme

21 Prill 2006 – Mbledhje e Komitetit Ekzekutiv të KOKSH

Më datë 21 Prill 2006, Komiteti Ekzekutiv zhvilloi në zyrat e KOKSH mbledhjen e tij të radhës. Anëtarët të pranishëm në mbledhje diskutuan sipas rendit të ditës i cili ishte si vijon:

- Informacion mbi mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të ACNOs, zhvilluar nga 1- 4 Prill 2006 në Seul të Koresë;
- Bursat Olimpikë “Pekin 2008”;
- Bursat Mesdhetare;
- Projekti i Federatës së Mundjes për kualifikimin e tranjerëve;
- Projekti i Akademisë lëvizëse;
- Shqyrtim i dokumentacionit për anëtarësim të Shoqatës së Lojës Bridge;
- Seminari mbi Legjislacionin Sportiv;
- Konfirmim për pjesmarje në Festivalin Olimpik Rinor Dimëror “Jaca 2007” 18-23 Shkurt 2007, Spanjë;
- Konfirmim për pjesmarje në Festivalin Olimpik Rinor Veror “Belgrade 2007” 22-27 Korrik 2007.
- Mbledhja e Komisionit Teknik;
- Mbledhja e Këshillit të Arbitrazhit Sportiv;
- Mbledhja e Komisionit të “Sportit për të Gjithë”
- Të ndryshme;

CIO dhe Solidariteti Olimpik, përcaktohen sportistët përfitues të bursës Olimpikë

Në vijim të procedurave të aplikimit në lidhje me programin e “Bursa Olimpikë për Sportistë”, KOKSH ka kënaqësinë të informoj se janë konfirmuar nga CIO dhe Solidariteti Olimpik sportistët që do të përfitojnë nga ky program. Në këtë kuadër KOKSH ka arritur të përfitojë 7 Bursave Olimpikë për sportistë.

Përfituesit e bursa janë:

Atletikë

Klodiana Shala; Elton Bitincka

Peshëngritje

Gerti Trasha; Fetie Kasaj; Endri Haxhihyseni; Erkand Qerimaj

Mundje

Ergys Mirukaj

27-30 Prill 2006 – "Pescara 2009"- Sekretari i Përgjithshëm i KOKSH në mbledhjet e Komisionit Teknik të ICMG

Në kuadër të përgatitjeve për Lojërat e ardhëshme Mesdhetare "Pescara 2009", Sekretari i Përgjithshëm i KOKSH Satvri Bello i cili është anëtar i Komisionit Teknik të ICMG mori pjesë në mbledhjen e këtij komisioni e cila u mbajt në Pescara të Italisë në datat 28-29 Mars 2006. Për këtë qëllim, anëtarët e Komisionit vizituan disa nga ambientet sportive të përfunduara dhe ato në punim. Komisioni i cili pa nga afër punimet në infrastrukturë, do të dalë me një raport përfundimtar.

3 Maj 2006 – Sporti Shqiptar i Bridge, takim pune në KOKSH

Përfaqësues të sportit të Bridge (lojë me letra), sport i ri ky në Shqipëri, u pritën nga Sekretari i Përgjithshëm i KOKSH z. Bello. Në takim u bisedua mbi anëtarësimin e këtij sporti pranë KOKSH e cila ka marrë aprovimin paraprak të Komitetit Ekzekutiv, por vendimi përfundimtar për njohjen e saj do të merret në Asamblenë e 11 vjetore të KOKSH. Nga përfaqësuesit e këtij sporti u konfirmua se së shpejti ky sport do të zhvillojë asamblenë e tij të parë.



Nga mbledhja e kryetarëve të komisioneve të KOKSH

5 Maj 2006 - Mbledhje e Kryetarëve të komisioneve të KOKSH

Menjëherë mbas mbledhjes së Komitetit Ekzekutiv të KOKSH i cili ka përcaktuar datën e zhvillimit të Asamblesë së 11 vjetore të KOKSH, komisionet përbërse të tij kanë nisur nga puna për përgatitjen e raporteve vjetore të punës për vitin 2005. Për këtë qëllim, Presidenti Domi dhe Sekretari i Përgjithshëm Bello kanë zhvilluar në zyrat e KOKSH një takim pune të përbashkët me kryetarët e këtyre komisioneve.

8 Maj 2006 – Presidentët e KOKSH dhe F.SH. të Çiklizmit, takim në KOKSH

Presidenti Domi, priti në zyrat e KOKSH në një takim pune Presidentin e FSH Çiklizmit z. Skënder Hanxhaku, Sekretarin e FSHÇ z. Genci Angjeli dhe së bashku me ta një sipërmarrës Italian, prodhues materialeve sportive çiklistike i cili ishte njëkohësisht edhe anëtar i Federatës së Çiklizmit të rajonit të Vareses. Në takim z. Hanxhaku prezantoi punën e mirë të FSHÇ, paraqitjet e mira në rezultate por edhe masivizim të sportit të çiklizimit kohët e fundit. Nga ana e KOKSH Presidenti Domi i siguroi të ftuarit se KOKSH do të mbështesi me të gjitha mundësitë që ka, FSHÇ-it për çuarjen përpara të këtij sporti Olimpik..

15 Maj 2006 – KOKSH në mbështetje të sportistëve të rinj të Çiklizmit

Presidenti Domi ofroi një pritje të veçantë për çiklistët e ekipit Kombëtar të të rinjëve të cilët arritën sukses në turneun që u zhvillua në Mal i Zi “Trofeu i qytetit të panairëve”, të cilët më pas dolën në një konferencë për shtyp. Domi u shpreh se KOKSH është i kënaqur me arritjen e rezultateve të marra nga të rinjtë që premtojnë dhe shpreson në rikthimin e çiklizmit në lavdinë e mëparëshme. Presidenti Domi duke i inkurajuar sportistët për të vazhduar këtë rrugë me rezultate, theksoi se KOKSH ka projekte në mbështetje të sportistëve të rinjë dhe programme kualifikimi për trainerët. Një theks të rëndësishëm z. Domi e vuri në bazën materiale të këtij sporti e cila duhet të jetë bashkëkohore dhe në standartet e vendeve të tjera. Për këtë MTKRS, KOKSH, Federata dhe sponsorë duhet të jenë më të angazhuar në plotësimin e këtyre standarteve të domosdoshme për të arritur rezultate. Në mbyllje të konferencës për shtyp z. Domi u shpreh duke thënë: “Dëshiroj që edhe çiklizmin ta shohim në “Pekin 2008” dhe padyshim “Pescara 2009”.



Nga pritja e çiklistëve të rinj nga Presidenti Domi

8-13 Maj 2006 - MEMOS IX

Përgjegjësja e marrëdhënieve me Median, Publikun dhe Marketingun e KOKSH znj. Elda Gjoka, ka vijuar modulën e tretë të Master Ekzekutiv për Administrimin e Organizatave Sportive (MEMOS), i cili u zhvillua në Ragusa të Italisë në ambjentet e “Scuola dello Sport”. Ky modul kishte për subjekt “Menaxhimi i Burimeve Njerëzore” i cili është edhe një nga pikat më të rëndësishme në fushën e sportit.

15-16 Maj 2006
Dita Olimpikë e Vrapimit – Peshkopi 2006

Në qytetin e Peshkopisë, me mbështetjen e KOKSH, është organizuar “Dita Olimpikë e Vrapimit, Peshkopi-2006”. Gjatë dy ditëve në këtë veprimtari Olimpikë, morën pjesë aktivisht nxënësit e shkollave të mesme “Seid Najdeni”, “Nazmi Rushiti” dhe shkollat 9-vjeçare të qytetit të Peshkopisë “Selim Alliu”, “Demir Gashi”,



Nga Dita Olimpikë e Vrapimit – Peshkopi 2006

“Irfan Hajrullai” dhe “Myslim Shehu”. Nxënësit pjesëmarrës garuan në distancat 400, 600, 800 dhe 1000 metra sipas grupmoshave dhe në të morën pjesë 560 djem dhe 560 vajza. Përveç aktivitetit të Ditës Olimpikë të Vrapimit në qytetin e Peshkopisë janë organizuar aktivitete të ndryshme artistike dhe sportive-kulturore dhe në fund të aktivitetit u shpërndanë çmime dhe çetifikata për pjesëmarrësit. Ky aktivitet u mbështet nga KOKSH dhe pati vëmendjen e bashkëpunimin e Bashkisë Peshkopi, Drejtorisë Arsimore Dibër, Klubit Sportiv “Korabi” por në koordinimin dhe organizimin e kësaj veprimtarie meritë e veçantë i takon Komitetit Olimpik Rajonal Dibër.

22 Maj 2006 – AOSH, mbledhje e bordit

Akademia Olimpikë Shqiptare, në prag të zhvillimeve të Asamblesë së 11 vjetore të KOKSH dhe për të vijuar punën e saj për vitin 2006, zhvilloi në ambjentet e AEFS “Vojo Kushi” mbledhjen me anëtarët e bordit, të cilët diskutuan mbi :

1. Raporti i AOSH në Asamblenë e 11 të KOKSH
2. Rishqyrtim i programit vjetor të AOSH për vitin 2006

24 Maj 2006 – Mbledhje e Komisionit të Financë-Marketing

Më datë 24 Maj 2006 në ambjentet e Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar u zhvillua mbledhja e Komisionit të Financës dhe Marketingut. Rendi i ditës në këtë mbledhje ishte:

- Diskutime mbi Draft-Raportin e Financë-Marketingut të KOKSH për vitin 2005.

29 Maj 2006 – Mbledhje e Komitetit Ekzekutiv të KOKSH në prag Asambleje

Komiteti Ekzekutiv i KOKSH zhvilloi mbledhjen e saj të radhës në ambjentet e Hotel “Leonardo”, shkëmbi i Kavajës Durrës. Anëtarët e KE diskutuan mbi përgatitjet dhe marrejn e masave, në kuadër të organizimit të Asamblesë së 11-të vjetore të KOKSH e cila do të mbahet më datë 3 Qershor 2006, po në hotel “Leonardo”.



Nga mbledhja e Komitetit Ekzekutiv, Hotel Leonardo

INFORMACIONE NGA FEDERATAT SPORTIVE

Volejboll

Maj 2006 Përfundon sezoni 2005/2006

Federata Shqiptare e Volejbollit zyrtarisht ka përfunduar veprimtaritë kombëtare të sezonit 2005-2006. Si pas FSHV, renditja përfundimtare e skuadrave të Kampionatit Kombëtar dhe Kupës së Shqipërisë është:

Kampionati Kombëtar

Meshkuj	Femra
1. Dinamo	1. Teuta
2. Teuta	2. Dinamo
3. Studenti	3. Tirana
4. Skënderbeu	4. Studenti
5. Vllaznia	5. Aulona
6. Tirana	6. Minatori
7. Erzeni	7. Krutja
8. Flamurtari	8. Korabi
9. Elbasani	9. Skënderbeu
	10. Partizani
	11. Pogradeci

Kupa e Shqipërisë

Meshkuj	Femra
1. Studenti	1. Dinamo
2. Dinamo	2. Teuta
3. Teuta	3. Tirana
4. Skënderbeu	4. Aulona

Peshëngritje

Fetie Kasaj medalje të argjenda në Kampionatin European për femra - senior


Në Kampionatin e 19-të European për femra-të rritur, i cili u zhvillua në Poloni në datat 26 Prill - 4 Maj, sportistja Fetie Kasaj i mbështetur nga treneri i saj Faruk Kalleshi ka arritur të rrëmbejë 3 medalje argjendi në të tre kategoritë, shtytje, shkëputje dhe dy garësh. Ajo ka konkuruar në peshën 58k dhe ka arritur këto rezultate:

Shkëputje - 97kg, Shtytje - 130kg dhe në dy garësh 227kg

Gjymnastikë

Ornela Çuko medalje argjendi

Federata Shqiptare e Gjymnastikës me një ftesë të bërë nga homologët e tyre Rumun janë përfaqësuar në Turneun Ndërkombëtar të Poleshtit në datat 6-7 Prill me gjymnasten Ornela Çuko, trenerin Ferdiand Mara dhe gjyqtaren ndërkombëtare Fatbardha Shtrepi. Gjymnastja zhvilloi një garë shumë të mirë në katër garësh por në disiplinën e kërcimit të kalit ajo arriti të renditet në vendin e dytë duke marrë medalje argjendi dhe duke u vlerësuar ndër gjymnastet me të mira të aktivitetit.



Fetie Kasaj në kampionatin e 19 European për femra-Poloni 2006

THE WORLDWIDE OLYMPIC PARTNERS / PARTNERË ME SHTRIRJE BOTËRORE



KOKSH - SPONSORËT LOKALË NË SHQIPËRI

Sponsorë Krenarë të Pjesëmarrjes së Shqipërisë në "Torino 2006" (Lojrat Olimpikë Dimërore, edicioni XX)



Furnizues Zyrtarë:

